



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2564/5 prot

Datë 30.10.2023

V E N D I M
Nr. 1094/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.10.2023 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-74014-06-30-2023, me objekt: “Rehabilitim dhe rritje kapacitetesh të gjimnazit Pojan”, me fond limit 53,738,542.00 Lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26-07-2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Maliq me adresë Bulevardi “Rinia”, Maliq

Ankimues: Operatori ekonomik “INA” SHPK me NIPT J61814009W dhe adresë Rruga “Besim Imami”, mbrapa karburantit, Myslym Shyri, Tiranë

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03-07-2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-74014-06-30-2023, me objekt: “Rehabilitim dhe rritje kapacitetesh të gjimnazit Pojan”, me fond limit 53,738,542.00 Lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26-07-2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

II.2 Në datën 26.07.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 03.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|-----------------|----------------------------------|
| 1. “INA” SHPK | 37.686.500,00 lekë, skualifikuar |
| 2. “Nika ” SHPK | 39.121.057,30 lekë, skualifikuar |
| 3. “2 N” SHPK | 39.800.000.00 lekë, skualifikuar |

4. “Cara” SHPK	40.568.220,00 lekë, skualifikuar
5. “Cogren ” SHPK	42.235.000,00 lekë, skualifikuar
6. “T & XH” SHPK	42,837.978,00 lekë, skualifikuar
7. “Asi-2ACO” SHPK	43.227.550,00 lekë, skualifikuar
8. “Zeqillari” SHPK	47.701.449,00 lekë, skualifikuar
9. “BE-IS” SHPK	48.300.005,00 lekë, skualifikuar
10. “Ada-Co” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
11. “Shendelli” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
12. “Aurora Konstruksion” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
13. “I.C.C Group” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
14. “Pepa Group” SHPK	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 18.10.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Anulimit të procedurës së prokurimit.

II.5. Operatori ekonomik “INA” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsytet si më poshtë:

1- Sipas pikës 2.3.9 Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 3. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme*
- 5. Certifikate për leje transporti të leshuar nga Bashkia dhe për mjetet me qera,*

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme.]*
- 6. Certifikate për leje transporti të leshuar nga Bashkia*

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretet.

*b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes. Operatori Ekonomik “INA” shpk në formularin e vetëdeklarimit, shtojca 8 ka deklaruar se disponon mjetin kamionçinë me vinç deri 3.5 ton me targë {***}. Nga dokumentacioni*

provues i paraqitur nga OE, bazuar në pamjet fotografike të mjetit rezulton se kamionçina me targë {***} nuk disponon vinç.

2- Sipas pikës 2.3.9 Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 3. Police sigurimi (e vlefshme)
 4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme
 5. Certificate për leje transporti të leshuar nga Bashkia dhe për mjetet me qera,
 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 4. Police sigurimi (e vlefshme)
 5. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme.]
 6. Certificate për leje transporti të leshuar nga Bashkia
- Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit të APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet të rezultojnë vetëm për përdorim vetjak por edhe për përdorim nga të tretet.

c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes. Operatori Ekonomik "INA" shpk në formularin e vetëdeklarimit, shtojca 8 ka deklaruar se disponon kamion vetëshkarkues deri në 18 ton me targë {***}. Nga dokumentacioni provues i paraqitur për mjetin kamion vetëshkarkues me targë {***}, rezulton se në lejën e qarkullimit pika 23 (masa maksimale e autorizuar) është 32 ton.

3- Sipas pikës 2.3.9 Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë:

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti të shoqerohet me fotografi të dukshme
5. Certificate për leje transporti të leshuar nga Bashkia dhe për mjetet me qera,
 1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 4. Police sigurimi (e vlefshme)

5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit te APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet te rezultojne vetem per perdorim vetjak por edhe per perdorim nga te tretet.

d) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes. Operatori Ekonomik “INA” shpk në formularin e vetëdeklarimit, shtojca 8 ka deklaruar se disponon kamion vetëshkarkues deri në 18 ton me targë {***}. Nga dokumentacioni provues i paraqitur për mjetin kamion vetëshkarkues me targë {***}, rezulton se në lejën e qarkullimit pika 23 (masa maksimale e autorizuar) është 32 ton.

4- Sipas pikës 2.3.9 Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit,si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
3. Police sigurimi (e vlefshme)
4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme
5. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia dhe per mjetet me qera,

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
2. Leje qarkullimi (e vlefshme)
3. Certificate e kontrollit teknik (e vlefshme)
4. Police sigurimi (e vlefshme)
5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]
6. Certificate per leje transporti te leshuar nga Bashkia

Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit te APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet te rezultojne vetem per perdorim vetjak por edhe per perdorim nga te tretet.

e) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Operatori Ekonomik “INA” shpk në formularin e vetëdeklarimit, shtojca 8 ka deklaruar se disponon mjetin kamionçinë deri 3.5 ton me targë {***} në pronësi të tij. Nga dokumentacioni provues i paraqitur nga OE(Leje qarkullimi ,Çertifikaten e kontrollit teknik ,Police sigurimi) rezulton se kamionçina deri 3.5 ton me targë {***} është në pronësi të Z/G. L si dhe mungon fotografia e mjetit. 5- Sipas pikës 2.3.9 Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon

ofertuesit te kualifikuar I pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si më poshtë :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet:

- 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 3. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 4. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme*
- 5. Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia dhe per mjetet me qera,*

1. Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

- 2. Leje qarkullimi (e vlefshme)*
- 3. Certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)*
- 4. Police sigurimi (e vlefshme)*
- 5. Mjeti te shoqerohet me fotografi te dukshme.]*

6. Certifikate per leje transporti te leshuar nga Bashkia Ne rastin e mjeteve me qera sipas njoftimit te APP nr. 4916/2 prot date 14.07.2022 ,referuar dokumentacionit ,mjetet nuk duhet te rezultojne vetem per perdorim vetjak por edhe per perdorim nga te tretet.

*f) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre duke paraqitur aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes. Operatori Ekonomik “INA” shpk në formularin e vetëdeklarimit, shtojca 8 ka deklaruar se disponon mjetin Eskavator me targë {***} të marrë me qera .Nga dokumentacioni provues i paraqitur nga OE rezulton se në kontratën noteriale të qirasë (Kontratë qiraje Nr rep. {***}, Nr koleksioni {***} datë 22.03.2023 me Z/O. P) dhe nga fotot e paraqitura mjeti është fadromë.*

II.6. Në datën 23.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa protokolluar me nr. 2564 prot., datë 23.10.2023 dhe me nr. ankimi elektronik A/2023/3518 e operatorit ekonomik “INA” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.7. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2564/3 prot., datë 23.10.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “INA” SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 5656/3 prot., datë 26.10.2023, protokolluar me tonën me nr. 2564/4 prot., datë 27.10.2023 me lëndë “Dërgohet vendim” është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.9. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes "INA" SHPK dhe me shkresën nr. 5656/3 prot., datë 26.10.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

"[...] Në formularin e ankimit operatori ekonomik paraqet ankesë se: "Për mjetin kamioncinë nuk disponon vinc, komisioni i vlerësimit të ofertave bazohet vetëm në fotografitë të paraqitura, por në bazë të ligjit të prokurimit publik vkm 285, datë 19.05.2021 neni 82 pika 2 paragrafi i fundit citon "Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë." Duke u bazuar në LPP autoriteti kontraktor duke u bazuar vetëm në fotot dhe duke bërë një vlerësim sa më të drejtë duhet minimalisht të kishte kërkuar një sqarim qoftë edhe disa foto të tjera të cilat tregojnë që kjo kamioncinë është me vinc. Gjithsesi duke marrë shkas nga skualifikimi i bëj me dije Komisionit të Vlerësimit të Ofertave bashkëngjitur kësaj ankese do të gjeni edhe foto më të qartë

Ky keqkuptim nga ana e K.V.O ka ardhur si pasoje e kësaj të marre të fotos ku është gjykuar që më e rëndësishme ka qenë që të evidentohet qartësisht targa e mjetit. A.K bazuar në ligjin "Per Prokurimin Publik dhe Rregulloren per "Miralimin e rregullave te prokurimit publik" ka pasur per detyre qe per cdo gje te paqarte te kerkoje sqarime nga operatori ekonomik. Nese do te ishin ndjekur keto hapa ligjor nuk do te kishim sot nje arsye me teper per tu skualifikuar".

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlereson se Operatori ekonomik "Ina" shpk ka paraqitur ne fazen e pare te vleresimit shtojcen nr.8 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit", ku ka deklaruar se per permbushjen e kriterit te mesiperme ka deklaruar kontrate qiraje per mjetin me Kamioncinë me Targë AA {***} me nr. Rep {***}, Nr. Kol {***}, date 29.04.2023. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentet provues te paraqitur nga operatori ekonomik "Ina" ShPK, rezulton se foto e paraqitur për mjetin me targe AA {***} nuk tregohet se mjete disponon vinc.*

*Nga dokumentacioni i paraqitur ne ankesen e operatorit ekonomik "Ina" shpk, rezulton për mjetin me targe AA {***} jane paraqitur foto te detajuara nga ku rezulton se e mjete disponon vinc.*

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të ankesës vlerëson se mjete me targe AA {*} disponon vinc dhe plotëson kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.**

*II. [...] Ne formularin e Ankimit Operatori ekonomik paraqet ankese ne lidhje me kapacitetin e kamionave. Ne dokumentet e tenderi kerkohet "Kamion vetshkarkues deri ne 18 ton" 2 cope. Sipas Komisionit te Vlersimit te Ofertave kamionët AA{***} dhe AA{***} nuk e plotesojne kete kusht pasi kapaciteti maksimal i kamionave eshte 32 ton.*

Por duke vene re ne proces verbalin e ngarkuar ne SPE "PER ARGUMENT!MIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM' në argumentimin e bërë nga komisioni i vleresimit te ofertave përshkruhet:" Kamion veteshkarkues deri ne 18 ton Kërkohen dy kamionë pasi kemi volume te medha te punimeve per germim, shtresa rrugore ne sheshin e objektit, prishje strukturash betoni etj. "Duke marre shkas nga ky argumentim kompania jone ka paraqitur dy kamione ku kapaciteti mbajtes per secilin kamion eshte perafersisht 15 ton. Pasi nese do te merret kapaciteti maksimal për një sasi kaq të madhe volumesh duke u bazuar ne argumentimin e bere nga KVO, atëherë çdo operator mund të paraqiste edhe një kamion i cili ka një peshe maksimale 5 ton por kapaciteti mbajtës është logjikisht më i vogël. Pra nëse KVO e interpreton që kamioni duhet të jetë me peshe maksimale deri në 18 ton atëherë KVO bie ndesh me argumentimin e saj se keta kamionë kerkohen për heqjen e volumeve të mëdha të punimeve për germim, shtresa rrugore në sheshin e objektit prishje strukturash betoni etj. Gjithashtu lidhur me këtë pikë i rikujtojmë KVO se në raste në procedura të tjera me të njëjtën kërkesë ose me kërkesa të ngjashme lidhur për peshën e makinerive është marrë në konsideratë kapaciteti mbajtës i makinës. Ju lutem mund të na thoni përse është e njejta kërkesë por vleresimi është me dy standarde. Atehere kërkesa per Kriteret per evazive nga KVO per te bere nje interpretim te dyfishte ne lidhje me kete kriter. Insitojme edhe nje here qe kjo kerkese eshte e permbushur nga ana e kompanise tone dhe autoritetit duhet te ndryshoje kete gjykim. Mjetet e kerkuara nuk kane per qellim te plotesojne kushtet per te qene ne kapacitet maksimal 18 ton sepse kjo le shume hapesire per keqinterpretim sepse ne qarkullim mund te kete mjete te cilet mund te kene te percaktuar si peshe maksimale te autorizuar peshen 18 Ton dhe pesha e mjetit te jete 17.999 kilogram cfare e ben te palogjikshme kryerjen e nje veprimtarie nga ky mjet dhe nese nje operator ekonomik do ta dispononte nje te tille sipas logjikes se AK do te ishte operator i kualifikuar cfare do e bente te pamundur përmbushjen e objektit te kontrates Perceptimi i operatorit ekonomik "Ina" shpk duke pare dhe volumet e punimeve te preventivit ne menyre logjike nisur dhe e nga eksperiencat e meparshme me kete A.K ka deklaruar mjetet, te cilat kane kapacitetin mbajtes jo me shume se 18 ton.

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlereson se Operatori ekonornik "Ina" shpk ka paraqitur në fazën e parë të vlerësimit shtojcen nr.8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", ku ka deklaruar se për përmbushjen e kriterit te mesiperme ka paraqitur kontrate qiraje për kamionët me targe AA{***} dhe AA{***} Sipas lejes se qarkullimit per mjetet e mesiperme rezulton se masa maksimale e autorizuar e kamionëve eshte 32 ton. Duke marre parasysh se sipas proces verbalit te argumentimit jane kerkuar 2 kamione pasi kemi volume te medha punimesh germimi, shtresa rrugore, punime prishje betoni etj, komisioni i shqyrtimit te ankeses vlereson se mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik jane me masë maksimale të autorizuar 32 ton dhe bazuar ne natyren e punimeve qe do te kryhen ne kete objekt sipas projektit dhe volumeve te punimeve, kryerja e punimeve me mjete te ketij tonazhi nuk sjell probleme në infrastrukturen rrugore.*

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të ankesës vlerëson se mjetet me targa AA {*} dhe AA {***} plotësojnë kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.**

III. Ne formularin e Ankimit Operatori ekonomik paraqet ankese në lidhje me argumentin për të cilin është bërë skualifikimi i operatorit ekonomik, me argumentimin se operatori ka deklaruar se ka në pronësi mjetin me targa AA{***}, ju bëjmë me dije se bashkangjitur dokumentacionit të dorëzuar është paraqitur edhe kontrata e blerjes së këtij mjeti me Nr.rep {***} Nr.kol {***} date 01.10.2021, ku cilesohet se G. L e ka kryer shitjen e mjetit të tij pranë shoqërisë "INA" shpk. Në bazë të nenit 705 të Kodit Civil kjo kontratë ka hyre në fuqi në datën 01.10.2021 dhe te dyja palet kanë rënë dakort mbi këtë kontratë. Automatikisht ky mjet është në pronësi të firmës INA shpk. Ju theksojme se për arsye të shoqërisë kjo makinë është e bllokuar në lidhje me një kredi e cila do të zhbllokohet se shpejti për të rifreskuar dokumentacionin e ri. Ju ritheksojme edhe njëherë se kjo pikë për skualifikim nuk qëndron. Gjithashtu ju rikujtojmë se në bazë të VKM 285 datë 19.05.2021 neni 82 pika 2 paragrafi i fundit citon "Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit të cilët duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në cdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë". Insistojmë edhe njëherë që edhe ky argumentim bie poshtë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se Operatori ekonomik "Ina" shpk ka paraqitur në fazën e parë të vlerësimit shtojcën nr.8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", ku ka deklaruar se për përmbushjen e kriterit të mësipërm ka paraqitur mjetin kamioncinë me targë AA {***}. Komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vlerësuar se nga autoriteti Kontraktor për të vertetuar disponueshmërinë e mjeteve është kërkuar:

- Per mjetet që shënohen ne regjistra publike duhet të paraqitet:
 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 3. Police sigurimi (e vlefshme)
 4. Afjete re shoqerohet me fotografi të dukshme
 5. Certificate për leje transporti të lëshuar nga Bashkia

Operatori ekonomik ka paraqitur kontrate shitblerje Nr.Rep {***}, nr.kol {***}, datë 01.10.2021 për blerjen e mjetit me targë AA {***}, të shoqëruar me Leje qarkullimi (e vlefshme), certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), Police sigurimi (e vlefshme), Mjeti të shoqërohen me fotografi të dukshme, Certificate për leje transporti të lëshuar nga Bashkia të cilën vërteton se mjeti është blerë nga shoqëria "Ina" shpk.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se duke qenë se operatori ekonomik ka paraqitur kontratën e shit-blerjes për blerjen e mjetit me targë AA {***}, njëkohësisht vërteton se ky mjet është në pronësi të kompanisë "Ina" ShPK.

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të ankesës vlerëson se mjeti me targa AA {*} plotëson kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.**

IV. Argumentimi i katërt për të cilin është bërë skualifikimi është në lidhje me mjetin i cili nuk është ekskavator por fadromë. Në dokumentet e tenderit kërkohet "Ekskavator" 1 copë. Sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në bazë të kontratës noteriale dhe fotove rezulton se mjete është fadromë. Në kontratën noteriale të qirasë midis palëve ku objekt i kontratës ndër të tjera ka qenë dhe marrje me qira e mjetit teknologjik me targë {***} dhe nr. shasie {***} e markes JBC. Duke mos qenë një eksperte e njohjes se mjeteve teknologjike noteria ku është bërë kontrata e qirasë e ka emërtuar me emrin fadromë për arsye sepse dhe në lejen e qarkullimi për këtë pjese mungon përcaktimi final i mjetit. Nga të dhënat e mësipërme po te bejme nje kerkim te thjeshte per mjetin ne baze te numrit te shasise dhe markës së mjetit evidentohet shumë lehtë që mjete është i përbërë nga nje krah hidraulik në pjesën e përparme e cila shërben për gërmime të një volumi shumë herë më të madh se sa mund të përballoje nje fadrome.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlereson se Operatori ekonomik "Ina" shpk ka paraqitur një kontrate qiraje nr.rep, {***}, nr.kol {***}, date 22.03.2023, per marrjen me qira të mjetit fadromë, referuar mjetit te paraqitur nga operatori ekonomik dhe fotove, si dhe referuar punimeve te cilat do te kryhen ne objekt sipas projektit dhe preventivit të punimeve, rezulton se mjete i paraqitur nga operatori ekonomik me krah hidraulik dhe përpara dhe mbrapa mund të realizoje punimet e përcaktuara në projektin dhe preventivin e punimeve. Mjete fadromë eshte funksional si per prishjet e objektit shtyrjen levizjen e materialeve inerte si dhe gërmimet e dheut.

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të ankesës vlerëson se mjete me targë AD MT 65 plotëson kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.

Përfundimisht KSHA bazuar në kërkesat kualifikuese të përcaktuara DST, dokumentacionit të paraqitur nga **Operatori Ekonomik "Ina" ShPK**, pretendimeve të tij si dhe Kualifikim i Ofertave, ligji Nr.162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,

KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESËS REKOMANDON:

I. Pranimin e ankesës së **Operatorit Ekonomik "Ina" shpk** "[...].

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues "INA" SHPK dhe me shkresën nr. 5656/3 prot., datë 26.10.2023, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, konkretisht citoj:

"[...] Në formularin e ankimit operatori ekonomik paraqet ankesë se: "Për mjetin kamioncinë nuk disponon vinc, komisioni i vlerësimit të ofertave bazohet vetëm në fotografitë të paraqitura, por në bazë të ligjit të prokurimit publik vkm 285, datë 19.05.2021 neni 82 pika 2 paragrafi i fundit citon "Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë." Duke u bazuar në LPP autoriteti kontraktor duke u bazuar vetëm në fotot dhe duke bërë një vlerësim sa më të drejtë duhet minimalisht të kishte kërkuar një sqarim qoftë edhe disa foto të tjera të cilat tregojnë që kjo kamioncine është me vinc. Gjithsesi duke marrë shkas nga skualifikimi i bëj me dije Komisionit të Vlerësimit të Ofertave bashkëngjitur kësaj ankese do të gjeni edhe foto më të qartë

Ky keqkuptim nga ana e K.V.O ka ardhur si pasoje e kendit te marre të fotos ku është gjykuar që më e rëndësishme ka qenë që të evidentohet qartësisht targa e mjetit. A.K bazuar ne ligjin "Per Prokurimin Publik dhe Rregulloren per "Miralimin e rregullave te prokurimit publik" ka pasur per detyre qe per cdo gje te paqaite te kerkoje sqarime nga operatori ekonomik. Nese do te ishin ndjekur keto hapa ligjor nuk do te kishim sot nje arsye me teper per tu skualifikuar".

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlereson se Operatori ekonomik "Ina" shpk ka paraqitur ne fazen e pare te vleresimit shtojcen nr.8 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit", ku ka deklaruar se per permbushjen e kriterit te mesiperme ka deklaruar kontrate qiraje per mjetin me Kamioncinë me Targë AA {***} me nr. Rep {***}, Nr. Kol {***}, date 29.04.2023. Operatori ekonomik ka paraqitur dokumentet provues te paraqitur nga operatori ekonomik "Ina" ShPK, rezulton se foto e paraqitur për mjetin me targe AA {***} nuk tregohet se mjete disponon vinc.*

*Nga dokumentacioni i paraqitur ne ankesen e operatorit ekonomik "Ina" shpk, rezulton për mjetin me targe AA {***} jane paraqitur foto te detajuara nga ku rezulton se e mjete disponon vinc.*

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të ankesës vlerëson se mjete me targë AA {*} disponon vinc dhe plotëson kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.**

II. [...] Ne formularin e Ankimit Operatori ekonomik paraqet ankese ne lidhje me kapacitetin e kamionave. Ne dokumentet e tenderi kerkohet "Kamion vetshkarkues deri ne 18 ton" 2 cope. Sipas Komisionit te Vlersimit te Ofertave kamionët AA{***} dhe AA{***} nuk e plotesojne kete kusht pasi kapaciteti maksimal i kamionave eshte 32 ton. Por duke vene re ne proces verbalin e ngarkuar ne SPE "PER ARGUMENT!MIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM' në argumentimin e bërë nga komisioni i vleresimit te ofertave përshkruhet:" Kamion vetshkarkues deri ne 18 ton Kërkohen dy kamionë pasi kemi volume te medha te punimeve per germim, shtresa rrugore ne sheshin e objektit, prishje strukturash betoni etj. "Duke marre shkas nga ky argumentim kompania jone ka paraqitur dy kamione ku kapaciteti mbajtes per secilin kamion eshte perafersisht 15 ton. Pasi nese do te merret kapaciteti maksimal për një sasi kaq të madhe volumesh duke u bazuar ne argumentimin e bere nga KVO, atëherë çdo operator mund të paraqiste edhe një kamion i cili ka një peshe maksimale 5 ton por kapaciteti mbajtës është logjikisht më i vogël. Pra nëse KVO e interpreton që kamioni duhet të jetë me peshe maksimale deri në 18 ton atëherë KVO bie ndesh me argumentimin e saj se keta kamionë kerkohen për heqjen e volumeve të mëdha të punimeve për germim, shtresa rrugore në sheshin e objektit prishje strukturash betoni etj. Gjithashtu lidhur me këtë pikë i rikujtojmë KVO se në raste në procedura të tjera me të njëjtën kërkesë ose me kërkesa të ngjashme lidhur për peshën e makinerive është marrë në konsideratë kapaciteti mbajtës i makinës. Ju lutem mund të na thoni përse është e njejta kërkesë por vleresimi është me dy standarde. Atehere kërkesa per Kriteret per evazive nga KVO per te bere nje interpretim te dyfishte ne lidhje me kete kriter. Insitojme edhe nje here qe kjo kerkese eshte e permbushur nga ana e kompanise tone dhe autoritetit duhet te ndryshoje kete gjykim. Mjetet e kerkuara nuk kane per qellim te plotesojne kushtet per te gene ne kapacitet maksimal 18 ton sepse kjo le shume hapesire per keqinterpretim sepse ne qarkullim mund te kete mjete te cilet mund te kene te percaktuar si peshe maksimale te autorizuar peshen 18 Ton dhe pesha e mjetit te jete 17.999 kilogram cfare e ben te palogjikshme kryerjen e nje veprimtarie nga ky mjet dhe nese nje operator ekonomik do ta dispononte nje te tille sipas logjikes se AK do te ishte operator i kualifikuar cfare do e bente te pamundur përmbushjen e objektit te kontrates Perceptimi i operatorit ekonomik "Ina" shpk duke pare dhe volumet e punimeve te preventivit ne menyre logjike nisur dhe e nga eksperiencat e meparshme me kete A.K ka deklaruar mjetet, te cilat kane kapacitetin mbajtes jo me shume se 18 ton.

Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses vlereson se Operatori ekonornik "Ina" shpk ka paraqitur në fazën e parë të vlerësimit shtojcen nr.8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", ku ka deklaruar se për përmbushjen e kriterit te mesiperme ka paraqitur kontrate qiraje për kamionët me targe AA{***} dhe AA{***} Sipas lejes se qarkullimit per mjetet e mesiperme rezulton se masa maksimale e autorizuar e kamionëve eshte 32 ton. Duke marre parasysh se sipas proces verbalit te argumentimit jane kerkuar 2 kamione pasi kemi volume te medha punimesh germimi, shtresa rrugore, punime prishje betoni etj, komisioni i shqyrtimit te ankeses vlereson se mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik jane me masë maksimale të autorizuar 32 ton dhe bazuar ne natyren e punimeve qe do te kryhen ne kete objekt sipas projektit dhe volumeve te punimeve, kryerja e punimeve me mjete te ketij tonazhi nuk sjell probleme në infrastrukturen rrugore.

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ankesës vlerëson se mjetet me targa AA {*} dhe AA {***} plotësojnë kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.**

III. Ne formularin e Ankimit Operatori ekonomik paraqet ankese në lidhje me argumentin për të cilin është bërë skualifikimi i operatorit ekonomik, me argumentimin se operatori ka deklaruar se ka në pronësi mjetin me targa AA{***}, ju bëjmë me dije se bashkangjitur dokumentacionit të dorëzuar është paraqitur edhe kontrata e blerjes së këtij mjeti me Nr.rep {***} Nr.kol {***} date 01.10.2021, ku cilesohet se G. L e ka kryer shitjen e mjetit të tij pranë shoqërisë "INA" shpk. Në bazë të nenit 705 të Kodit Civil kjo kontratë ka hyre në fuqi në datën 01.10.2021 dhe te dyja palet kanë rënë dakort mbi këtë kontratë. Automatikisht ky mjet është në pronësi të firmës INA shpk. Ju theksojme se për arsye të shoqërisë kjo makinë është e bllokuar në lidhje me një kredi e cila do të zhbllokohet se shpejti për të rifreskuar dokumentacionin e ri. Ju ritheksojme edhe njëherë se kjo pikë për skualifikim nuk qëndron. Gjithashtu ju rikujtojmë se në bazë të VKM 285 datë 19.05.2021 neni 82 pika 2 paragrafi i fundit citon "Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit të cilët duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë". Insistojmë edhe njëherë që edhe ky argumentim bie poshtë.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se Operatori ekonomik "Ina" shpk ka paraqitur në fazën e parë të vlerësimit shtojcën nr.8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", ku ka deklaruar se për përmbushjen e kriterit të mësipërm ka paraqitur mjetin kamioncinë me targë AA {***}. Komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vlerësuar se nga autoriteti Kontraktor për të vertetuar disponueshmërinë e mjeteve është kërkuar:

- Per mjetet që shënohen ne regjistra publike duhet të paraqitet:
 1. Leje qarkullimi (e vlefshme)
 2. certifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
 3. Police sigurimi (e vlefshme)
 4. A{jeti re shoqerohet me fotografi të dukshme
 5. Certifikate për leje transporti të lëshuar nga Bashkia

Operatori ekonomik ka paraqitur kontrate shitblerje Nr.Rep {***}, nr.kol {***}, datë 01.10.2021 për blerjen e mjetit me targë AA {***}, të shoqëruar me Leje qarkullimi (e vlefshme), certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), Police sigurimi (e vlefshme), Mjeti të shoqërohen me fotografi të dukshme, Certifikatë për leje transporti të lëshuar nga Bashkia të cilën vërteton se mjeti është blerë nga shoqëria "Ina" shpk.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se duke qenë se operatori ekonomik ka paraqitur kontratën e shit-blerjes për blerjen e mjetit me targe AA {***}, njëkohësisht vërteton se ky mjet është në pronësi të kompanisë "Ina" ShPK.

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të ankesës vlerëson se mjeti me targa AA {*} plotëson kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.**

IV. Argumentimi i katërt për të cilin është bërë skualifikimi është në lidhje me mjetin i cili nuk është ekskavator por fadromë. Në dokumentet e tenderit kërkohet "Ekskavator" 1 copë. Sipas Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në bazë të kontratës noteriale dhe fotove rezulton se mjeti është fadromë. Në kontratën noteriale të qirasë midis palëve ku objekt i kontratës ndër të tjera ka qenë dhe marrje me qira e mjetit teknologjik me targe {***} dhe nr. shasie {***} e markes JBC. Duke mos qenë një eksperte e njohjes se mjeteve teknologjike noteria ku është bërë kontrata e qirasë e ka emërtuar me emrin fadromë për arsye sepse dhe në lejen e qarkullimi për këtë pjesë mungon përcaktimi final i mjetit. Nga të dhënat e mësipërme po te bejme nje kerkim te thjeshte per mjetin ne baze te numrit të shasise dhe markës së mjetit evidentohet shumë lehtë që mjeti është i përbërë nga nje krah hidraulik në pjesën e përparme e cila shërben për gërmime të një volumi shumë herë më të madh se sa mund të përballoje nje fadrome.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vlerëson se Operatori ekonomik "Ina" shpk ka paraqitur një kontratë qiraje nr.rep, {***}, nr.kol {***}, date 22.03.2023, per marrjen me qira të mjetit fadromë, referuar mjetit te paraqitur nga operatori ekonomik dhe fotove, si dhe referuar punimeve te cilat do te kryhen ne objekt sipas projektit dhe preventivit të punimeve, rezulton se mjeti i paraqitur nga operatori ekonomik me krah hidraulik dhe përpara dhe mbrapa mund të realizoje punimet e përcaktuara në projektin dhe preventivin e punimeve. Mjeti fadromë eshte funksional si per prishjet e objektit shtyrjen levizjen e materialeve inerte si dhe gërmimet e dheut.

Referuar sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të ankesës vlerëson se mjeti me targë AD MT 65 plotëson kriterin e kërkuar në DST 2.3.9.

Përfundimisht KSHA bazuar në kërkesat kualifikuese të përcaktuara DST, dokumentacionit të paraqitur nga **Operatori Ekonomik "Ina" ShPK**, pretendimeve të tij si dhe Kualifikim i Ofertave, ligji Nr.162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar,

**KOMISIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESËS
REKOMANDON:**

II. Pranimin e ankesës së **Operatorit Ekonomik "Ina" shpk** "[...].

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në autoritetin kontraktor (referuar kjo informacionit të autoritetit kontraktor të dërguar në KPP) dhe as në Komisionin e Prokurimit Publik.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, konkretisht aktit të trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “INA” SHPK, kështu që rrjedhimisht, për sa kohë nuk janë paraqitur argumente nga subjektet e interesuara, Komisioni në mbështetje të nenit 115 pika 3 gërma a, mbyll çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INA” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-74014-06-30-2023, me objekt: “Rehabilitim dhe rritje kapacitetesh të gjimnazit Pojan”, me fond limit 53,738,542.00 Lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 26-07-2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
 3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INA” SHPK.
 4. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri